Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria –Vlada-Government*
*Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë- Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije-Ministry of Education Science and Technology*
Zyra e Sekretarit të përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the General Secretary

Numër: 2-589
Datë: 10-03-2016

Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të nenit 38 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare, nr. 82, 21 tetor 2010), nenit 38 të Ligjit për të Ardhurat Personale(Gazeta zyrtare, nr. 22/14 gusht 2015) dhe nenit 17 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), nxjerr:

# V E N D I M
## Për ndalesat në tatimin në paga

1. Për ndalesat në burim në tatimin nga pagat e tatueshme të paguara punëtorëve dhe pagesat për shërbimet profesionale, teknike, të menaxhimit, financiare, pagesat për Kontratat mbi Vepër, Marrëveshjet e shërbimeve të veçanta etj.

2. Ndalesat nga burimi në tatimin nga pagat e tatueshme do të bëhen nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit. Sipas kësaj, të gjitha Marrëveshjet për Shërbime të veçanta, të lidhura me punëmarrësit në vitin 2015 apo më vonë, e të cilat janë si obligime të papaguara do të kryhen siç përcaktohet në Ligjin për të Ardhurat Personale (Gazeta zyrtare, nr. 22/14 gusht 2015).

3. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## A r s y e t i m

Duke u mbështetur në dispozitat e shënuara më lartë dhe duke pasur parasysh rastin e pagesave të mëparshme deri në momentin e hyrjes në fuqi të Ligjit për të Ardhurat Personale (Gazeta zyrtare, nr. 22/14 gusht 2015) nuk janë bërë ndalesat në burim në tatimin nga pagat e tatueshme, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Vendimi u dërgohet:**
1. Zyrës së SP/MASHT;
3. Departamentit te Administratës dhe Financave;
4. Divizionit te personelit/MASHT;
5. Arkivit.

Alush Istogu

U.d. i sekretarit të përgjithshëm